# DËSHMI ARKIVI

**A-455501**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Mbi 50 ndeshje secili me Kosovën: Valon Berisha dhe Fidan Aliti mbyllin karrierën ndërkombëtare si legjenda |
| ADRESA | `https://albeu.com/sport/mbi-50-ndeshje-secili-me-kosoven-valon-berisha-dhe-fidan-aliti-mbyllin-karrieren-nderkombetare-si-legjenda/1017596/` |
| BURIMI | albeu.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 18 shtator 2026, 14:28:26 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 18 shtator 2026, 14:25:24 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `7cba3dcafb0e3ca39871554988af074ebc9c4db6be3b001ada51fcc624472c4b` |
| TEKSTI | `a2efd3111ca0d900e42037a9b7af1fe9ea223e7a6c7dbe9752e67395a16baf79` |
| PAMJA | `246715c6b6a937d9d49eebf2e58c87cb8fda101b6b9ea594270cd7980e50aae6` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `e2653d3cac66a8af9e115b59474b7697be45661e33e5bbe843600a0b73a63eba` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `565145c81569d96b39079f1db9ed9e378c0d0ec132a26687d139f465bf7be21b` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/e2653d3cac66a8af9e115b59474b7697be45661e33e5bbe843600a0b73a63eba`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Mbi 50 ndeshje secili me Kosovën: Valon Berisha dhe Fidan Aliti mbyllin karrierën ndërkombëtare si legjenda



Valon Berisha dhe Fidan Aliti njoftuan të premten se kanë vendosur t'i japin fund karrierës së tyre ndërkombëtare me përfaqësuesen e Kosovës.

Që nga pranimi i Kosovës në UEFA dhe FIFA, të dy futbollistët dhanë një kontribut të çmuar, duke e merituar plotësisht statusin e legjendave të ekipit.

Valon Berisha, tashmë 33-vjeçar, kishte kaluar nëpër të gjitha grupmoshat e Norvegjisë, duke luajtur për ekipet U17, U19 dhe U21. Ai regjistroi gjithashtu 20 paraqitje me kombëtaren A norvegjeze, përpara se më 9 maj 2016 t'i thoshte "PO" Kosovës.

Debutimin me "Dardanët" e bëri nën drejtimin e Albert Bunjakit, në ndeshjen e famshme kundër Finlandës. Berisha realizoi edhe golin që i siguroi Kosovës pikën e parë në kualifikueset e Kupës së Botës.

Ai ishte pjesë e përfaqësueses në secilën fushatë kualifikuese, por nuk arriti ta përjetonte pjesëmarrjen në një turne të madh, qoftë në Kampionat Evropian apo në Kupën e Botës.

Në 52 paraqitje me fanellën e Kosovës, Berisha shënoi katër gola dhe regjistroi pesë asistime. Në total, ai grumbulloi 3 mijë e 703 minuta lojë për përfaqësuesen.

Paraqitja e tij e fundit ishte në Prishtinë kundër Zvicrës. Berisha hyri në fushë në minutën e 87-të të takimit që u mbyll me rezultat 1-1.

Pas përfundimit të rrugëtimit ndërkombëtar, ai do të përqendrohet tërësisht te Zurichu, me të cilin e ka nisur në mënyrë të shkëlqyer këtë edicion.

të fundit/
Mbi 50 ndeshje secili me Kosovën: Valon Berisha dhe Fidan Ali…
TAV Maqedonia anulon kufizimin për hyrjen pa pagesë në zonën "Hu…
Duhet të qëndrojmë vigjilentë"/ Macron: Franca dhe aleatët d…
Kaos në Ceuta, mijëra emigrantë vërshojnë drejt kampit të ri pran…
Përfundon Kursi i Avancuar për Snajperët, FSK forco…
Katër shoqatat e magjistratëve do ta çojnë ligjin për pagat …
Kim Kardashian në spital, gjendja shëndetësore i kujton…

ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

Të njëjtin vendim mori edhe Fidan Aliti, i cili falënderoi Kosovën dhe konfirmoi tërheqjen nga futbolli ndërkombëtar.

Përpara se t'i bashkohej Kosovës, Aliti kishte zhvilluar dy ndeshje miqësore me Shqipërinë. Megjithatë, në vitin 2017 ai zgjodhi ta vazhdonte karrierën me fanellën dardane.

Ndeshjen e parë për Kosovën e luajti më 11 qershor 2017 kundër Turqisë, në kuadër të kualifikueseve për Kupën e Botës.

Aliti siguroi një vend në formacionin titullar në përballjen me Letoninë, më 13 nëntor 2017. Që nga ajo kohë, ai mbeti një zgjedhje e padiskutueshme deri në ardhjen e Franco Fodas, me trajnerin gjerman që fillimisht preferoi Amir Rrahmanin dhe Lumbardh Dellovën në 11-shen bazë.

Edhe ndeshjen e fundit me Kosovën Aliti e zhvilloi ndaj Turqisë, në play-offin e Kupës së Botës. Foda e aktivizoi atë gjatë 10 minutave të fundit të takimit.

Në përgjithësi, mbrojtësi regjistroi 64 paraqitje me përfaqësuesen e Kosovës, duke kontribuar me një gol dhe dy asistime.

Me largimin e Valon Berishës dhe Fidan Alitit, Kosova u jep lamtumirën dy futbollistëve që lanë gjurmë me fanellën dardane, ndërsa përfaqësuesja përgatitet të hyjë në një epokë të re.

Shtuar më 18.09.2026 16:25

Tags: Fidan aliti , Kombëtarja e kosovës , Liga e Kombeve , valon berisha



Yamal thumbon Kane në garën për Topin e Artë: Çmimi i takon më të mirit,…



Bylis përforcon mbrojtjen me një talent shqiptar nga Maqedonia e Veriut


Tri prurje të reja dhe disa mungesa në listën e Kosovës për Ligën e…


Valon Berisha dhe Fidan Aliti i japin fund aventurës me Kosovën



Dinamo kërkon fitoren e katërt radhazi, Ilir Daja vlerëson Laçin dhe kërko…


Xavi shpall grumbullimin e parë me Holandën, Zechiel dhe Van Bommel marrin…


Cristiano Ronaldo vazhdon me Portugalinë, grumbullohet për Ligën e…



Shqipëria U-17, publikohet lista për dy miqësoret e shtatorit ndaj Malit të Zi


© 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko…
Kërko

**Kryesore**
Erion Veliaj
Free Esim
Zgjedhjet 2025
Belinda Balluku
SPAK
Kombëtarja

**Kategori**
Lifestyle
Showbiz
Tech
Shëndetësi
Argetim
Enciklopedi

**Linqet**
Live tv shqiptare
Moti në Shqipëri
Travel
Horoskopi
Livescore
News from Albania

**Tags**
Edi Rama
Albania News
Ilir Meta
Piranjat
gazeta, tv, portale
Sali Berisha

**Moti**
Moti në Tiranë
Moti në Prishtinë
Moti në Shkup
Moti në Durrës
Moti në Prizren
Moti në Tetovë

© 2003 - Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kontaktoni | Kushtet e Përdorimit | Privacy Policy | Powered by: orihost.com |

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.